

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky akt normativ është propozuar në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës.

Në datën 1 janar 2022 fillojnë efektet e plota të zbatimit të kundërvajtjeve administrative që lidhen me hyrjen në fuqi të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Zbatimi i plotë i këtyre dispozitave nënkupton që faturat e lëshuara nga tatimpaguesit duhet të jenë të gjitha të fiskalizuara. Përmbushja e detyrimeve ligjore të fiskalizimit do të sjellë vështirësi dhe, për rrjedhojë, dhe pamundësi operimi për tri kategori tatimpaguesish.

Ky akt normativ ka si qëllim krijimin e kushteve për dhënien e kohës së mjaftueshme subjekteve tatimpaguese, të cilat kanë detyrimin për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, kryesisht subjekteve të biznesit të vogël që e kanë të vështirë përshtatjen me teknologjinë dhe që nuk kanë peshë në realizimin e të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit, si dhe subjekteve që ofrojnë furnizime jetike për konsumatorët finalë, persona të tatueshëm apo të patatueshëm, që janë furnizimet me ujë të pijshëm dhe energji elektrike. Gjithashtu, bankat dhe institucionet financiare kanë parashtruar problematika teknike të lidhura me raportimin e pagesave që nuk varen prej tyre, por kushtëzohen nga teknologjia në përgjithësi dhe ndërveprimi i sistemeve në veçanti. Nga ana e tatimpaguesve, që operojnë në këtë fushë, është kërkuar zyrtarisht në mënyrë të përsëritur shtyrja e afatit të zbatimit të ligjit të fiskalizimit për t`ju dhënë kohë për të ngritur dhe përshtatur infrastrukturën e nevojshme.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektakti janë:

- Rritja e efektivitetit të procesit të fiskalizimit, duke e bërë sa më të thjeshtë për komunitetin e biznesit dhe duke mos pasur si qëllim penalizimin e tyre;
- Mbështetja e komunitetit të biznesit në përshtatjen sa më të shpejtë dhe sa më të mirë me këtë sistem/proces të ri të fiskalizimit, i cili mundëson një

metodologji raportimi në kohë reale ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Duke qenë se akti normativ propozohet të miratohet në kushtet e nevojës dhe urgjencës, nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun XIV ka përcaktuar kundërvajtjet administrative të cilat vijnë si pasojë e shkëljes së dispozitave të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar. Duke marrë parasysh kohën, proceset teknike të cilat janë të lidhura me këtë kategori tatimpaguesish, konsiderojmë se afati i aplikimit të sanksioneve duhet shtyrë me qëllim që t’u jepet koha e mjaftueshme subjekteve tatimpaguese të plotësojnë detyrimet ligjore që vijnë nga ligji nr.87/2019.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë kërkesat e vazhdueshme të shoqatës së bankave lidhur me problematikat teknike në raportimin e pagesave, të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM), si dhe të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratimi i këtij akti normativ do të ndikojë në përmbushjen e qëllimit të ligjit nr.87/2019 dhe rritjen e bashkëpunimit midis subjekteve tatimpaguese dhe administratës tatimore. Ndërkohë, vetë administrata tatimore ka pasur në fokus implementimin e sistemit të fiskalizimit duke analizuar gjatë gjithë periudhës ecurinë e këtij procesi. Aktualisht, me përfundimin e afatit të shtyrjes së zbatimit të sanksioneve të miratuara me aktin normativ nr.27, datë 1.7.2021, është vlerësuar dhe konstatuar që një kategori e konsiderueshme tatimpaguesish të biznesit të vogël janë në pamundësi objektive për të përmbushur detyrimet ligjore të fiskalizimit.

Nga analizat e realizuara nga administrata tatimore, rezultojnë aktualisht rreth 45.026 tatimpagues ose 55% e totalit të biznesit të vogël. Kjo kategori ndahet ndërmjet atyre të cilët janë pajisur me certifikatë fiskalizimi, por nuk lëshojnë fatura, 23.172 tatimpagues dhe të kategorisë që nuk janë pajisur ende me certifikatë fiskalizimi pranë AKSH-it, 21.854 tatimpagues. Gjithashtu, këta tatimpagues nuk rezultojnë si shitës në librat e blerjes së TVSH-së së popullatës së tatimpaguesve për vitin 2021.

Sektorët kryesorë ku ushtrojnë aktivitetin këta tatimpagues janë:

Kodi ekonomik	Nr i nipteve
Tregtia me pakicë	14 185
Aktivitetet e shërbimit të pijeve bar-kafe	7,374
Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë	2 843
Aktiviteti i taksive	1 761
Prodhimi	1 661
Transporti	1 206
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1 151
Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	1 070
Aktivitetet e dentistëve/mjekëve	829
Tregtia me shumicë	778
Ndërtimi	636
Aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera	544
Aktivitetet juridike	539
Aktivitetet e programimit informatik	503
Riparimi i artikujve personalë dhe familjarë p.k.t	502
Hotele dhe struktura të ngjashme	392
Agjenci	372
Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera	354
Përpunimi	306
Dhënia me qira	264
Aktivitetet e tjera argëtimi dhe çlodhëse p.k.t.	237
Aktivitetet e ndërmjetësimit	221
Aktivitetet e agjencive të udhëtimit	213
Aktivitetet e tjera	7 085
Totali	45 026

Administrata tatimore në mënyrë konstante dhe periodike, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, ka ndërmarrë iniciativa për të kontaktuar, ndihmuar, trajnuar këta tatimpagues për t'u përfshirë në proces, por megjithë vëmendjen maksimale ende rezultojnë tatimpagues të papërfshirë në proces.

Gjithashtu, shoqëri me kapital 100% shtetëror, që ofrojnë furnizime të shërbimeve të një rëndësie të veçantë (furnizim me drita, ujë etj.), kanë njoftuar në rrugë shkresore se ende nuk janë gati për të lëshuar fatura të fiskalizuara në datën 1 janar 2022, si dhe janë duke zhvilluar procedurat standarde të prokurimit publik, për kontraktimin e shërbimit, procedura të cilat zgjasin në kohë dhe parashikohet që afati i fillimit të lëshimit të faturave të fiskalizuara nga ana e tyre të jetë brenda periudhës kohore 31 mars-30 qershor 2022.

Numri i kontratave drejt të cilave Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) lëshon fatura është rreth 1.27 milionë dhe faturimi mujor për periudhën, 2110 është afërsisht rreth 4,6 miliardë lekë dhe TVSH mbi 917 milionë lekë (faturimi për 10-mujorin ka qenë mbi 51 miliardë dhe TVSH mbi 10 miliardë).

Nga totali prej 1.27 milionë abonentësh, kontrata për abonentë jofamiljarë janë 222.993, me faturim mujor për periudhën, 2110 prej rreth 2.6 miliardë lekësh dhe TVSH mbi 515 milionë lekë, ndërsa pjesa tjetër janë konsumatorë familjarë.

Po kështu, edhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM) ka njoftuar zyrtarisht se nga 58 ujësjetës në rang vendi, 23 prej tyre janë fiskalizuar dhe lëshojnë fatura, 13 janë të gatshme për të lëshuar fatura më 1 janar, ndërsa 22 shoqëri nuk e kanë filluar procesin dhe nuk janë gati për të lëshuar fatura në datën 1 janar.

Numri i kontratave drejt të cilave faturojnë këto 22 ujësjetës është 446.161 abonentë dhe faturimi mujor i tyre është rreth 514 milionë lekë, TVSH mbi 100 milionë.

Pikërisht për shkak të kushteve të vështira të krijuara dhe me qëllim mbështetjen e komunitetit të biznesit, duke qenë së bëhet fjalë edhe për një proces të ri që nuk është aplikuar më herët në vendin tonë, propozohet që zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative, që lidhen me zbatimin e ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, të fillojnë të aplikohen pas datës 30.6.2022, për:

- a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;
- b) tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;
- c) bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave, të lëshuara nga subjektet tatimpaguese.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj *Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës*, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj, ku mund të përmendim vendimet nr.24, datë 10.11.2006, nr.1, datë 6.2.2013, dhe nr.5, datë 5.2.2014, ka interpretuar kuptimin e termave “nevojë” dhe “urgjencë”. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmenden edhe elementi shoqëror i cili ka ardhur si pasojë e vështirësisë së këtyre kategorive të tatimpaguesve në implementimin e fiskalizimit. Gjykata Kushtetuese vlerëson se prania e nevojës dhe urgjencës në kushtet e nxjerrjes së një akti normativ me fuqinë e ligjit është e lidhur me ekzistencën e vetë normës. Këtë opinion ka shprehur dhe jurisprudenca kushtetuese ndërkombëtare duke vlerësuar se ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ që ka fuqinë e ligjit.

Emergjenca e lindur si pasojë e situatës së pasigurt dhe detyrimi kushtetues për plotësimin e nevojave të tatimpaguesve të shkaktuar nga hyrja në fuqi e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, konsiderohet si shkak për urgjencë.

Zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative, që lidhen me zbatimin e ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, propozohet të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022, për:

- a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;
- b) tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike.
- c) bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave, të lëshuara nga subjektet tatimpaguese.

Kjo me qëllim mbështetjen e komunitetit të biznesit që të familjarizohet me lehtësi, si dhe të përshtatet shpejt dhe mirë me sistemin/procesin e ri të fiskalizimit. Miratimi i këtij propozimi kërkon ndërhyrjen me urgjencë, e cila propozohet të adresohet nëpërmjet këtij akti normativ.

Duke qenë se procedura për miratimin e një projektligji kërkon një periudhë të gjatë kohore që nga propozimi deri në miratim, propozohet që ndryshimi i paraqitur në këtë projektakt të miratohet me akt normativ.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti normativ nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 2 nene:

Neni 1 i aktit normativ propozon që në kreun XV, pas pikës 7, të nenit “Dispozita kalimtare”, të shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. Përrjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022”, për tatimpaguesit si më poshtë:

- a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve final, persona të patatueshëm;*
- b) tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët final si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;*
- c) bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave të lëshuara nga subjektet tatimpagues.”.*

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi menjëherë dhe botimin në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE